

Studimet letrare në proces: teza, projekte, ide dhe rezultate

EVALDA PACI

MODELE TEKSTORE NË VEPRAT E LETËRSISË SË VJETËR SHQIPE (VËSHTRIM TEKSTOLOGJIK DHE TIPOLOGJIK)

Në një vështrim të përgjithshëm që ka të bëjë me natyrën përmbajtësore por dhe strukturimin e veprave që përfaqësojnë letërsinë e vjetër shqipe, ndër tekstet më të veçanta mund të konsiderohen pikërisht ato që në njëfarë mënyre janë hartuar nga vetë autorët e tyre nën qëllimin e qasjes së lexuesit ndaj punës së paraqitur dhe ndërmarrjes së vështirë për të sjellë në shqipen tonë vepra të një natyre të veçantë si nga përmbajtja, ashtu dhe nga destinacioni.

Në këtë pikëpamje, dhe disponimi i teksteve të caktuara mbetet i një rëndësie të veçantë për një sërë arsyes, ndër të cilat mund të jetë dhe fakti që ato ofrojnë të dhëna shumë të rëndësishme për autorin dhe rrethanat konkrete të përpilimit të veprës në fjalë.

Në pikëpamje të zotërimit të të dhënave konkrete mbi autorin dhe realizimin e një libri kompleks si ai i Gjon Buzukut, pasthënia e tij u ka ofruar studiuesve informacione që sado të varfra e të pamjaftueshme, të paktën kanë shërbyer që të ngrihen supozime e të kërkohen indice që mund të shpien në gjetje më konkrete që kanë të bëjnë me periudhën reale në të cilën autori mund të ketë ndjekur përgatitjen për shtyp të librit dhe me vendin në të cilin ai ndërkohë mund të ketë kryer veprimtarinë meshtarake të tij. Një sërë elementesh tekstore të tij janë bërë objekt diskutimi duke mos qenë mundësia e disponimit të të dhënave të tjera që do të ndihmonin të interesuarit për librin dhe historinë e tij të kuptonin diçka më tepër në lidhje me autorin, rendin meshtarak të cilit mund t'i përkiste, raportet e mundshme konkrete të tij me hierarkinë kishtare të kohës, gjuhët që mund të ketë njohur dhe konsultuar realisht gjatë përpilimit të veprës në fjalë etj. Nuk mund të lihet pa përmendur fakti që të dhëna të tilla të pamjaftueshme dhe mund të shpien në deduksione jo të sakta që për më tepër nuk ndihmojnë në gjetjen e përgjigjeve që kërkohen tashmë prej shumë kohësh.

Një vështirësi objektive akoma e pakapërcyer dhe në ditët e sotme mbetet mungesa e faqeve të para të librit, konsultimi i të cilave mund të ofronte përgjigje konkrete për shumë paqartësi që shtrohen për sqarim dhe sot e kësaj dite. Studiuesit do të ishin në zotërim të një kuadri më kompleks e më të pasur me të dhëna nëse do të disponoheshin dhe këto faqe, duke qenë se në pasthënie e librit nuk specifikohen emri i botuesit dhe i tipografisë në të cilën u realizua dalja në dritë të shtypit e librit në fjalë, të dhëna që zakonisht pritet të ofrohen në modele të tilla pasthëniesh. Sigurisht, referimi që autori u bën *shtampatorëve* në ato pak rreshta që përmban kjo pasthënie u përmbahet modeleve tekstore të kohës së tij,

por mbetet i mangët pikërisht për mungesën e saktësimi të mëtejme të detajeve që dhe sot e kësaj dite konsiderohen të paqartësuar.¹

Duke qenë i një përmbajtjeje dhe i një ndërtimi specifik për kohën, një libër orësh me një meshar të bashkangjitur (e që përbën pjesën mbizotëruese të tij në pikëpamje të vëllimit dhe rëndësisë) sigurisht që mund të kishte elemente tekstore po aq specifike në hyrje të tij, që do të kthjellonin përfundimisht dhe çështjen e modelit(apo modeleve) të konsultuara dhe nëse libri do të ishte aprovuar të botohej me lejimin tradicional të emërtuar *superiorum permissu*.

Vetë koha në të cilën mendohet të jetë realizuar për shtyp kjo vepër bën të mendosh vështirësinë konkrete në përpilimin e teksteve përbërëse të tij, në veçanti të atyre që u bënë dhe objekt diskutimi në klimën historike të Reformës dhe Kundërreformës.

Në emërtesat e Martin Camajt dhe të Namik Ressulit² në lidhje me këtë pjesë mjaft të rëndësishme dhe domethënëse në përbërje të veprës mbizotëron termi *kolofon*, i pranishëm dhe në regeste të terminologjisë së fushës studimore të filologjisë së tekstit në përgjithësi.³ Në botimin e parë kritik të librit të parë në gjuhën shqipe, përgatitur për botim pikërisht nga Namik Ressuli(Romë, 1958) dhe në një kohë të afërt me realizimin e punimit monografik të Camajt pikërisht mbi *Mesharin* dhe vendin e tij në studimet rreth gjenezës së traditës shkrimore të shqipes së kultivuar (Romë, 1960)⁴, serviret në fund të aparatit kritik të këtij botimi dhe një variant interesant i shkruar në gjuhën latine dhe i gatitur nga Atë Valentini S.I. i kolofonit, pikërisht si një shprehje e homazhit për rëndësinë e librit në fjalë por dhe për vetë tekstin me të cilin libri përmbyllet. Një model teksti si ai i kolofonit të librit të Gjon Buzukut ndeshet dhe në vepra të tjera të kohës, natyra përmbajtësore e të cilave jo domosdoshmërisht përkon me atë të librit tonë.⁵

¹ Meshari, botim kritik përgatitur nga E. Çabej, *Pjesa e dytë*, Tiranë, 1968, f. 387: *Përse ata qi shtamponjinë kishnë të madhe fëdigë, e aqë nukë mundë qëllonjinë se faj të mos banjinë, përse ndaj ta përherë nukë mundë jeshë...*

² N. Ressuli, *Il "Messale" di Giovanni Buzuku (riproduzione e trascrizione)*, Biblioteca Apostolica Vaticana, Roma, 1958, *Prefazione*, f. XVII.

³ Në përgjithësi mbahet si emërtim që përdorej në latinishten e vonë, por që kishte prejardhje nga greqishtja (*kolophōn*, cak, maje, fund). Zakonisht konceptohet si një diciturë që vendoset në faqet e fundme të botimeve. Emërtesat në fjalë kanë ndryshuar në periudha të caktuara, por në dorëshkrimet mesjetare dhe në inkunabulat tipografike në kolofon shfaqeshin dhe të dhëna që kishin të bënin me emrin e autorit dhe gjithashtu të vetë veprës, funksione që më vonë dhe u mbartën në frontespis.

⁴ M. Camaj, *Il «Messale» di Gjon Buzuku, contributi linguistici allo studio della genesi*, Shëjzat, Romë, 1960.

⁵ G. Devoto - G. C. Oli, *Vocabolario della lingua italiana*, Le Monnier, 2008, f. 583: *colophon*, s.m., lat.1.Sigla finale degli antichi libri a stampa o di alcune moderne edizioni di lusso, contenente il nome dello stampatore e altre indicazioni relative alla stampa. Ka fjalorë në të cilat gjinden dhe shpjegime që kanë të bëjnë me disponimin teknik dhe tipografik të kolofonit në vepra të caktuara. Shih sërish G. Devoto - G.C. Oli, *Vocabolario della lingua italiana*, Le Monnier, 2008 f. 581: *colofone* s.m.-1.disposizione tipografica

Modele tekstore në veprat e letërsisë së vjetër shqipe

Në regestet që dokumentojnë librat e botuar në mesjetën e vonë në fushë të historisë, të filozofisë, në fushë të mjekësisë, psikologjisë dhe një sërë temash të tjera që lidhen me shkencat e natyrës dhe ato humane, përmenden kolofonet si tekste përmbyllëse në të cilat dhe jepen interpretime të rëndësishme mbi çka flitet dhe parashtrohet në këto vepra.⁶

Frang Bardhi ka pajisur *Dicionarin* e tij me një sërë tekstesh të tilla me natyrë dedikuese dhe introductive e që lejojnë të kuptohet diçka më tepër në lidhje me një sërë faktorësh dhe rrethanash që kanë qenë veshja kontekstuale e realizimit të veprës së tij leksikografike. *Admonitio de erroribus*⁷ me të cilën pothuaj përmbyllet Dicionari latinisht-shqip i F. Bardhit (1635), përbën ndër të tjera një tekst sa modest dhe origjinal në pikëpamje të përmbajtjes së tij, që nuk ka pasur vëmendjen që është dëshmuar për kolofonin, ndërkohë që për autorin e tij disponohen të dhëna më të pasura dhe pse gjithashtu të pamjaftueshme sipas disa studiuesve. Këtu duhet shtuar dhe fakti që disponimi prej kësaj vepre të Bardhit i disa teksteve hyrëse të veprës, një prej të cilëve në latinishten librorë të kohës⁸, lehtëson brendësimin dhe interpretimin e një sërë rrethanash që lidhen dhe me historinë e librit të tij, Dicionarit kompleks në shumë pikëpamje dhe elemente tekstore, që ndër të tjera paraqitet dhe më i plotë në kuptimin e gjendjes fizike të tij.

I një natyre krejt të veçantë mbetet *Të Primitë përpara letërsisë* me të cilën introdiktohet vepra *Cuneus prophetarum* (1685) e Pjetër Bogdanit.⁹ *Të primitë* mbetet një tekst që transmeton qartë nota të një prirjeje pedagogjike dhe doktrinare në shkrimtarinë e autorit të kësaj vepre, por që paralajmëron dhe një linjë që do të ndiqet në mbarë shtjellimin e saj: me elemente ezegjetike dhe me detaje të një kulture që është pjesë e natyrshme e formimit të tij. Teksti në fjalë është dhe më i gjatë nëse krahasohet me të mëparshmit dhe përkon më së miri me vetë natyrën e veprës së Bogdanit, i cili në këtë përmasë në të cilën na paraqitet,

consistente nell'ordinare le ultime righe di un testo in lunghezza sempre decrescente a forma di trapezio regolare con la base minore in basso. dal lat.colophon, dal gr.kolophón"sommità" || sec. XVI.

⁶ I. Biffi, *Figure del pensiero medievale, La nuova razionalità (XIII secolo)*, Jaca Book, Città nuova, 2008, f. 111 v. Pa dashur të thellohem në këtë moment me një sërë detajesh që në fakt meritojnë vëmendje e janë indice konkrete të brendësimin tekstor dhe kuptimor të këtij teksti, mund të propozojmë të denjë për vëmendje dhe tekste analoge nga pikëpamja e vendit, destinacionit, gjatësisë tekstore por të shkruara në vepra të tjera dhe në periudha paksa më të vona.

⁷ B. Demiraj, *Dictionarium latino-epiroticum (Romæ 1635).....*, Botime Françeskane, Shkodër, 2008, f. 542-543.

⁸ B. Demiraj, *Dictionarium latino-epiroticum (Romæ 1635).....*, Botime Françeskane, Shkodër, 2008, f. 70-72.

⁹ P. Bogdani, *Cuneus prophetarum, botim kritik përgatitur nga A.Omari*, Tiranë, 2005, f. XVII v.

zgjedh dhe interpreton tekste biblike duke i dhënë në dimensione fragmentare dhe duke i vënë në funksion të mbarë linjës në të cilën është konceptuar kjo vepër.

Edhe tekstet e tjera të veprës së Bogdanit paraqiten të ndryshme në shumë pikëpamje nga ato të veprave pararendëse të saj dhe kjo për një sërë arsyes: natyra përmbajtësore dhe tekstologjike e vetë veprës, prirja për shtjellime e shpjegime të natyrës filozofike e teologjike që përshkon mbarë veprën etj.

Modelet tekstore të veprës së Bogdanit e në veçanti ato introduktivt mund të gjejnë qasje referenciale në vepra të ngjashme të shkruara në vise të tjera evropiane. Një vepër si ajo e Bogdanit, e konceptuar të paraqesë e të shtjellojë sprova në fushë të teologjisë e të historisë së filozofisë pa dyshim që mund të bëhet objekt qasjeje me vepra të tjera të realizuara në arealin evropian e që duhet të kenë pasur të njëjtin qëllim e objektiv qendror. Në këtë pikëpamje, përveç përjasjeve në fushë të shtjellimit të tematikës qendrore që shihet se është rrahur gjerësisht në arealet kishtarë dhe kulturore evropiane dhe para shekullit në të cilin jetoi dhe kreu Pjetër Bogdani veprimtarinë e tij meshtarake, dhe modelet tekstore që kanë paraprirë dhe introduktuar të tilla vepra analoge me atë të autorit tonë mund të bëhen objekt qasjeje dhe krahasimi tekstologjik e përmbajtësor.

Janë një mori veprash që në atë periudhë përmbanin letra hyrëse me shënime kushtimi ndaj personave dashamirës dhe mbështetës në pikëpamje ideologjike dhe shkencore të sprovave të ndërmarra nga autorët e këtyre veprave.

Në këtë pikëpamje mund të bëhen objekt qasjeje dhe letrat e kushtimit (të një natyre të theksuar poetike) që paraprijnë veprën e Bogdanit, autorët e të cilëve shfaqin nota vlerësimi mbi autorin dhe punën e tij me këtë vepër. Vetë gjurmimi studimor i përmbajtjes së tyre të çon menjëherë në përfundimin se secili prej shkruesve të atyre radhëve respektonte modele të njohura për kohën e për stilin ligjërimor të gjuhës së kulturës.

Në këtë kuptim, dhe në pikëpamje krahasuese me veprat e autorëve paraardhës, vepra e Pjetër Bogdanit paraqitet më e pasur në modele të tilla, të cilat i referohen një sërë destinacionesh: që nga vlerësimi dhe homazhi, deri te kushtimi ndaj personave që qenë aktorë të promovimit të botimit të kësaj vepre. Përveç këtyre, dhe teksti i titulluar *Al benigno lettore*, përbën një tjetër model të cilit mund t'i gjinden qasje referenciale dhe brenda traditës shkrimore e letrare të këtyre autorëve, duke qenë se përmban nota të përbashkëta si me *Admonitio de erroribus* të *Dictionarit latinisht-shqip* të Frang Bardhit, ashtu dhe me kolofonin e librit të Gjon Buzikut.¹⁰

¹⁰ P. Bogdani, *Cuneus prophetarum*, botim kritik përgatitur nga A. Omari, Tiranë, 2005, f. XX: *Al benigno lettore: Se il Sole hà le fue macchie, fe la Luce le fue ombre, fe il Cielo li fuoi mostri, non ti rechi meraviglia, ò Lettore, fe nel legger il mio Libro scorgerai qualch'errore. T'avvertisco, per scufrne alcuni, che lo Stampatore non ha cognizione della lingua Albanefe, e che io, per effer nato Macedone, non ho potuto haver la lingua Italiana del tutto purgata. In quanto poi alla frafe, sappi, che io scrivo per gente idiota, e scrivo per l'utile della Santa Fede, non per honor mio.*

Modele tekstore në veprat e letërsisë së vjetër shqipe

Mjaft elemente tekstore mund të bëhen objekt shqyrtimi në këtë vështrim dhe mund të dëshmojnë njëkohësisht që autorët e kësaj tradite shkrimore kishin përherë modele referimi sa u takon mënyrës së shtjellimit të teksteve të trajtuara si dhe vetë argumenteve që ata marrin përsipër të interpretojnë. Pranëvënja e tyre përherë ofron mundësi të vënies në dukje të përkimeve të pamohueshme në pikëpamje të konceptimit dhe parashtrimit të teksteve në fjalë.

BIBLIOGRAFI

- A. Omari, *Disa risi në fushën e botimit të teksteve të vjetra shqipe*, në Konferenca shkencore: *Çështje të studimeve diakronike të shqipes*, ASHAK, 2009.
- B. Corsani, *Esegesi. Come interpretare un testo biblico*, Piccola Collana Moderna Claudiana, 2001.
- B. Corsani, *Guida allo studio del Nuovo Testamento*, Società Biblica Britannica e Forestiera, Romë, 2005.
- B. Demiraj, *Dictionarium latino-epiroticum(Romæ 1635) per R.D.F.Blanchum*, Botime Françeskane, Shkodër, 2008.
- B. Demiraj, *Gjon Nikollë Kazazi dhe "doktrina" e tij*, ASHAK, Prishtinë, 2006.
- E. Çabej, *Shqipja në kapërcyell/epoka dhe gjuha e Gjon Buzukut*, botime Çabej, Tiranë, 2006.
- E. Çabej, *Studime etimologjike në fushë të shqipes VI(N-Rr)*, Tiranë, 2002.
- E. Çabej, *Studime shqiptare, Vepra të zgjedhura*, ASHAK, Prishtinë, 2008.
- E. Çabej, *Vepra e Gjon Buzukut në vështrim historik e gjuhësor*, në "Studime filologjike", nr. 1, 1979.
- E. Paci, *Cenni ed osservazioni linguistiche sul primo libro scritto in lingua albanese (1555)*, në *Studia Albanica*, 1-2, 2014.
- E. Paci, *Franciscus Blanchus: Dictionarium Latino-Epiroticum, Romæ 1635*, në *CERCETĂRI ISTORICE (Serie nouă)*, Editura Palatului Culturii, Iași, 2011.
- E. Paci, *Kolofoni në Mesharin e Gjon Buzukut*, në "Hylli i Dritës", nr. 4, 2012.
- E. Paci, *Letërsia e vjetër shqipe në kontekstin e historisë së letërsisë shqiptare*, në *Hylli i Dritës*, n.2, 2011.
- E. Paci, *Për një vështrim tekstologjik të Mesharit të Gjon Buzukut*, në "Hylli i Dritës", nr. 3, 2011.
- I. Biffi, *Figure del pensiero medievale, La nuova razionalità (XIII secolo)*, Jaca Book, Città nuova, 2008.
- I. Zamputi, *Çështje të shkrimit dhe të fillimit të letërsisë në gjuhën shqipe*, në "Hylli i Dritës", nr. 1-2, 1995.
- J. Bauer, *Dizionario di teologia biblica*, Morcelliana, Brescia, 1965.
- J. Rrota O.F.M., *Letratyra shqype për shkolla të mjesme*, Shkodër, 1925.
- J. Rrota O.F.M., *Per historin e alfabetit shqyp dhe studime tjera gjuhesore*, Botime françeskane, Shkodër, 2005.
- M. Camaj, *Il "Messale" di Gjon Buzuku, contributi linguistici allo studio della genesi*, Shêjzat, Romë, 1960.
- M. Ebner, S. Schreiber, *Introduzione al Nuovo Testamento*, Queriniana, Brescia, 2012.
- M. Kruja, *Nji studim analitik (Gjuha e Frang Bardhit dhe shqipja moderne)*, Botime Çabej, Tiranë, 2007.

- M. Roques, *Gjurmime mbi tekstet e vjetra shqipe e shkrime të tjera*, (perkthye nga frengishtja e pajisë me shenjime plotësuese nga W.Kamsi), Botime Françeskane, Shkodër, 2011.
- M. Roques, *Recherches sur les anciens textes albanais*, L.O.P.Geuthner, Paris, 1932.
- P. Bogdani, *Cuneus prophetarum, botim kritik përgatitur nga A.Omari*, ASHSH, Tiranë, 2005.
- P. Chiesa, *Elementi di critica testuale*, Pàtron editore, Bologna, 2002.
- R. Maisano, *Filologia del Nuovo Testamento*, Carocci editore, Romë, 2014.
- R. Maisano, *L'edizione del Nuovo Testamento di Wettstein*, në *Bollettino della Badia Greca di Grottaferrata*, n.45, 1991.
- R.J. Erickson, *Guida introduttiva all'esegesi del Nuovo Testamento (come vincere la paura del metodo critico)*, Edizioni San Paolo, Milano, 2007.